



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE**

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [dekanati@uni-pr.edu](mailto:dekanati@uni-pr.edu) • [ëëë.uni-pr.edu](http://ëëë.uni-pr.edu)

Ref. nr. **4115**

Prishtinë, **30.08.2019**

Në bazë të vendimit nr. 3732 të datës 18.07.2019, Komisioni vlerësues për zgjedhjen e personelit akademik- pozita nr.6, sipas konkursit për angazhim të bashkëpunorëve të jashtëm në Departamentin e Fizikës, të datës 11.07.2019 sjellë këtë:

**RAPORT**

Në konkurs janë paraqitur tre kandidatë, me këto të dhëna

Nr	Emri dhe mbiemri	Dokumente	Ditëlindja	Nota mesatare dhe institucioni			
				Bch.	Universiteti	Msc	Universiteti
1	<b>Msc. Arbër Zeqiraj</b>	Komplet.	21.08.1983	7.96	Prishtinës	8.77	Prishtinës
2	<b>Msc. Besnik Saramati</b>	Komplet.	03.06.1986	7.13	Prishtinës	8.54	Prishtinës
3	<b>Msc. Vezire Bajrami</b>	Komplet.	25.01.1988	8.34	Prishtinës	8.36	Prishtinës

Pozita 6. Bazat e matjeve në fizikë, (UN) (Fizikë O), Bazat e matjeve në fizikë, (UL) (Fizikë O).

Duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nr 2/475 të datës 08.09.2017, dhe Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së nr 2/486 dt 11.09.2017, aplikanti:

1. Msc. Arbër Zeqiraj – ka thirrjen asistent në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” Ekspertiza e tij është e njohur për Departamentin e Fizikës ku për shume vite i ka kryer ushtrimet laboratorike dhe numerike në lëndën perkatese (Bazat e Matjeve në Fizikë) në mënyrë profesionale dhe korrekte. Arber Zeqiraj ka regjistruar studimet e doktorates ne vitin akademik 2018/2019 në International Postgraduate School “Jozef Stefan” në Ljubljana – Slloveni. Po ashtu ka paraqitur 10 punime në revista dhe konferenca të ndryshme ku disa prej tyre janë të fushës përkatëse – metrologji. Nota mesatare në studimet bachelor më e vogël se 8 (7.96) bazuar në nenin 4, pika 3.2 të rregullorës për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nr 2/475 të datës 08.09.2017 e pamundeson anagzhimin e Arbër Zeqirajt në këtë pozitë.
2. Msc. Besnik Saramati – i ka përfunduar studimet bachelor (me notë mesatare – 7.13) dhe master (me notë mesatare – 8.54) në Departamentin e Fizikës. Nota mesatare në studimet bachelor më e vogël se 8 (7.96) bazuar në nenin 4, pika 3.2 të rregullorës për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nr 2/475 të datës 08.09.2017 e pamundeson anagzhimin e Arbër Zeqirajt në këtë pozitë.
3. Msc. Vezire Bajrami - i ka përfunduar studimet bachelor (me notë mesatare – 8.34) dhe master (me notë mesatare – 8.36) në Departamentin e Fizikës.

Duke pas parasysh kualifikimet e theksuara, notën mesatare në studimet bachelor dhe master, ekspertizën e deritanishme (dhe me pëlqimin paraprak të Departamentit të Fizikës), komisioni

proponon që për angazhim të bashkëpunëtorit të jashtëm për pozitën 6:

1. **Msc. Vezire Bajrami – të pranohet**
2. Msc. Arbër Zeqiraj – të refuzohet
3. Msc. Besnik Saramati – të refuzohet


29. 08. 2019    Prishtinë

Komisioni:

1. Prof. Dr Sadik Bekteshi, kryetar



2. Prof.Asoc.Dr. Sefer Avdiaj, anëtar



3. Prof. Dr. Skender Kabashi, anëtar

